

Dr. Bashkim Aljiji¹

UDC: 316.485.6:28-74

**ZGJIDHJA E KONFLIKTEVE NË DRITËN E QËLLIMEVE TË
SHERIATIT**

**РЕШАВАЊЕ НА КОНФЛИКТИ ВО СВЕТЛИНА НА ЦЕЛИТЕ НА
ШЕРИЈАТОТ**

**THE RESOLUTION OF CONFLICTS IN THE LIGHT OF THE
OBJECTIVES OF ISLAMIC LAW**

Abstract

This study examines the role of the higher objectives (*Maqāṣid al-Sharīʿah*) in addressing and resolving conflicts in the contemporary world. It argues that Islamic law (*Sharīʿah*) seeks to promote the comprehensive well-being (*maṣlaḥah*) and happiness of its adherents—spiritually and materially, in this life and the Hereafter. However, this noble objective and grand purpose of Islamic Sharia are not limited only to the lives of its followers who practice it as a form of worship. Rather, its influence extends beyond them, affecting the entire humanity through the light of its principles and higher objectives.

The followers of Islamic law (*Sharīʿah*) do not live in isolation from other people; rather, they constitute an integral part of human societies around the world—whether as a majority or a minority—and are therefore members of the societies in which they reside. Consequently, their happiness in this world cannot be achieved without the stability of society and the establishment of peace, security, and well-being within it, since the Muslim is an essential component of the broader social system of humanity in which he or she lives.

Undoubtedly, one of the most important pillars of prosperous societies is the attainment of security, stability, mutual understanding, and harmony, as well as the resolution of conflicts between individuals

¹ Doktor në fushën e studimeve evropiane për integrim & kryetar i këshillit të shkollarëve muslimanë në kantonin e Cyrihut-Zvicër.

and various groups within a society-and, more broadly, within the human family that inhabits this world.

Keywords: *objectives of Islamic law (Maqāṣid al-Sharī‘ah), peace, stability, human society, justice.*

Hyrje

Sheriati Islam, si një sistem hyjnor dhe fetar për rregullimin e jetës, synon lumturinë e ndjekësve të tij që i përmbahen dispozitave të tij si në këtë botë, ashtu edhe në botën tjetër. Ai përfshin interesat tokësore dhe shpirtërore, duke vendosur një ekuilibër të përkryer midis tyre. Megjithatë, ky qëllim madhështor dhe synim fisnik i Sheriatit Islam nuk kufizohet vetëm në jetën e ndjekësve të tij që e zbatojnë atë si formë adhurimi, por shtrihet përtej tyre, duke ndikuar në jetën e të gjithë njerëzimit përmes dritës së dispozitave dhe qëllimeve të tij.

Ndjekësit e Sheriatit Islam nuk jetojnë të izoluar nga njerëzit tjerë; ata janë pjesë e pandashme e të gjitha shoqërive njerëzore në mbarë botën, si në vende ku përbëjnë shumicë, ashtu edhe në ato ku janë pakicë. Kjo i bën ata anëtarë të plotë të shoqërive ku jetojnë dhe kontribuojnë. Prandaj, lumturia e tyre në këtë botë nuk mund të arrihet pa stabilitetin e shoqërisë dhe pa sigurimin e paqes, sigurisë dhe mirëqenies brenda saj, pasi myslimani është pjesë përbërëse e pandashme e sistemit të përgjithshëm të shoqërive njerëzore ku jeton.

Nuk ka dyshim se ndër shtyllat themelore të çdo shoqërie të lumtur janë siguri i paqes, stabilitetit, mirëkuptimit dhe harmonisë, si dhe zgjidhja e konflikteve ndërmjet individëve dhe grupeve të ndryshme brenda një shoqërie. Kjo vlen edhe për familjen njerëzore në tërësi, e cila, megjithëse e ndarë në kombe e shtete, jeton në një shtëpi të përbashkët që quhet **botë**.

Mund të thuhet shkurtimisht se qëllimi i përgjithshëm që synon të arrijë Sheriati Islam është “lumturia e individit dhe e shoqërisë, ruajtja e rendit dhe ndërtimi i botës me gjithçka që çon drejt së mirës dhe përsosmërisë njerëzore, në mënyrë që kjo botë të bëhet arë për botën tjetër, e njeriu të gëzojë lumturinë në të dyja botët.”²

² El-‘Aleml, Jusuf Hamid, (pa datë botimi), *El-Mekasid el-‘amme li-sh-sheri‘ati el-islamiye*, Kajro–Hartum: Dar el-Hadith & Ed-Dar es-Sudaniye, f. 83.

Nga ky këndvështrim buron edhe titulli i këtij hulumtimi, i cili trajton zgjidhjen e konflikteve në botë në dritën e synimeve (maqāsid) të Sheriatit Islam. Ky studim gjithashtu thekson rolin e fesë në përgjithësi dhe rolin e Islamit në veçanti në zgjidhjen e konflikteve dhe në arritjen e paqes e stabilitetit në shoqëritë njerëzore.

Kjo, ngase vendosja e drejtësisë dhe e barazisë, sigurimi i lirisë së mendimit, ofrimi i sigurisë dhe i qetësisë, janë pjesë thelbësore e synimeve madhore të Sheriatit.³ Të gjithë njerëzit janë robër të Allahut, dhe Ai është Krijuesi dhe Zoti i tyre, pavarësisht se sa të ndryshme mund të jenë konceptet e tyre për Të.

Intencat e Legjislacionit Islam (Mekasidu esh-Sheri'a) kanë për qëllim objektivat që Legjislacioni Islam synon të realizojë për interesin e njerëzve. Në mënyrë të përmbledhur, mund të thuhet se intenca e përgjithshme që Legjislacioni Islam synon të përmbushë është: “Lumturia e individit dhe e bashkësisë, mbrojtja e rendit shoqëror dhe ndërtimi i tokës me çdo gjë që sjell të mirën dhe përkryerjen e njeriut, në mënyrë që kjo botë të shërbejë si përgatitje për botën tjetër, dhe njeriu të arrijë lumturinë në të dy botët.”⁴

Për intencat e Legjislacionit Islam janë dhënë definicione të ndryshme, dhe në këtë rast do të mjaftohemi me definicionin vijues: “Intencat e Legjislacionit Islam janë nocione, urtësi dhe parime që Ligjvënësi i ka marrë në konsideratë në mënyrë të përgjithshme dhe specifike, me qëllim që të realizojë interesat e njerëzve.”⁵

Ndarja e intencave të Legjislacionit Islam

Dijetarët kanë sqaruar se intencat e Legjislacionit Islam ndahen në tre grupe, ose siç shprehet edhe Shatibiju: “Këto intenca nuk i tejkalojnë tre grupe: 1. Të domosdoshme; 2. Të nevojshme; 3. Të parapëlqyera.”⁶

³ El-Fasijj, Alal, (1983), *Mekasid esh-sheri'a el-islamijje ue mekarimuha*, Kasablankë: Matba'at en-Nexhah el-Xhedid, f. 3.

⁴ El-'Alemi, Jusuf Hamid, El-Mekasid el-'amme li-sh-sheri'ati el-islamijje, f. 83.

⁵ El-Jubi, Muhamed Sa'd ibn Ahmed ibn Mes'ud, (1998/1418 h.), *Mekasid esh-sheri'a el-islamijje ue 'alaqatuha bi-l-edille esh-she'r'iyye*, botimi i parë, Rijad: Dar el-Hixhre, f. 37.

⁶ Shatibijj, Ebu Ishak I, ibn M. M, el-Lahmijj, (pa vit botimi), *El-Muvafekat fi usuli-sh-sheri'a*, përgatiti M. Muhji-ed-Din Abdu-l-Hamid, Kajro: Mektebet Ali Muhamed Sabih ue euladuh, vëll. II, f. 8.

Dijetarët i kanë përmbledhur intencat e domosdoshme në pesë gjëra: mbrojtja e fesë, e jetës, e gjenezës, e pasurisë dhe e mendjes. Pra, në pesë domosdoshmëritë bën pjesë edhe mbrojtja e jetës dhe mbrojtja e mendjes.⁷

Këto pesë domosdoshmëri, dijetarët i kanë quajtur edhe pesë gjërat e tërësishme dhe universale, të cilat i konsiderojnë si baza dhe objektiva të përgjithshme të legjislacionit, që ai synon t'i mbrojë.⁸

Këto pesë qëllime themelore janë të pranuar nga të gjithë ndjekësit e feve dhe ligjeve qiellore për domosdoshmërinë e ruajtjes së tyre, ashtu siç është e domosdoshme edhe ruajtja e tyre për mbrojtjen e vetë jetës. Islami ka përcaktuar dispozita që sigurojnë ekzistencën, mbrojtjen dhe mirëmbajtjen e tyre.

Studiuesit bashkëkohorë në fushën e maqāsid al-sharī'a-s (qëllimeve të Sheriatit) theksojnë se këto qëllime nuk kufizohen vetëm në pesë domosdoshmëritë themelore që përfshihen tradicionalisht në konceptin e qëllimeve, por më e drejtë është që të zgjerohet rrethi i maqāsid al-sharī'a-s, duke përfshirë edhe ato çështje që më herët nuk janë përfshirë, për sa kohë që është vërtetuar vlefshmëria e tyre dhe ekziston bazë në Kur'an dhe Sunet për t'i futur ato në listën e qëllimeve të Sheriatit.⁹

Udhëzime të dobishme nga qëllimet (synimet) e sheriatit në zgjidhjen e konflikteve në shoqëritë njerëzore

Qëllimet (synimet) juridike të sheriatit përbëjnë themelet dhe objektivat e Sheriatit Islam, dhe përfshijnë pesë domosdoshmëritë themelore që i kanë sjellë të gjithë të dërguarit e Allahut. Bazuar në këtë, ato janë të pandryshueshme, të qëndrueshme dhe të përherëshme,¹⁰ sepse jeta njerëzore nuk mund të qëndrojë pa ruajtjen e këtyre pesë domosdoshmërive. Qëllimet e sheriatit kanë vlefshmëri në çdo kohë dhe vend, pasi ato merren me nevojat e çdo epoke dhe rrethanave të saj, duke përfaqësuar një pikë referimi të sigurt për t'u rikthyer në raste mospërputhjes apo dallimesh. Në këtë mënyrë, çështjet e ndryshueshme gjykohen në bazë të parimeve të qëndrueshme. Vetë fakti që këto

⁷ Shih: Shatibijj, Ebu Ishak I, ibn M. M, el-Lahmijj, botimi i parë, *El-Muvafekat fi usuli-sh-sheri'a*, Fās: al-Bashīr bi-Natīxha, vëll. III, f. 18.

⁸ El-'Alemi, Jusuf Hamid, *El-Mekasid el-'amme li-sh-sheri'ati el-islamijje*, f. 80.

⁹ Siddikijj, M. N., (2016), *Mekasid esh-sheri'a ue el-hajatu el-mu'asira*, përkthyer në arabisht nga M. Rahmetullah en-Nedvijj, botimi i parë, Damask: Dar el-Kalem, f. 48.

¹⁰ Shatibijj, *El-Muvafekat fi usuli-sh-sheri'a*, vëll. I, f. 77-79.

qëllime janë të pandryshueshme dhe të përhershme, tregon se ato përmbajnë udhëzime të rëndësishme dhe efektive që i drejtohen të gjithë njerëzve, e jo vetëm muslimanëve.

Sheriati Islam synon të realizojë lumturinë e individëve, të grupeve dhe të shoqërive njerëzore, si dhe ndërtimin e kësaj bote në kuptimin më të gjerë të fjalës “ndërtim”, që përfshin jetën materiale dhe shpirtërore. Ai gjithashtu synon ndërtimin e një shoqërie të drejtë e të qëndrueshme dhe sigurimin e një të ardhmeje të ndritur për mbarë njerëzimin. Prandaj, është e domosdoshme të flitet për rolin e Fesë Islame në zgjidhjen e konflikteve në dritën e qëllimeve të sheriatit.

Sheriati ka ardhur me parime të larta dhe me bazamente të qëndrueshme për realizimin e qëllimeve të tij dhe për ruajtjen e domosdoshmërive jetike të njerëzve. Ndër këto parime përfshihen: drejtësia, dëshmia për të vërtetën, zhdukja e çdo lloj korrupsioni, shmangia e dëmit, eliminimi i çdo forme padrejtësie, sinqeriteti, përmbushja e premtimeve, ruajtja e të drejtave dhe kthimi i amanetit tek pronari i tij legjitim. Të gjitha këto parime janë thellësisht dhe drejtpërdrejt të lidhura me arritjen e paqes në shoqëritë njerëzore përmes zgjidhjes së konflikteve.

Themelet e të gjitha këtyre parimeve gjenden në Librin e Allahut. Këtu do të përmendim dy parime madhore, mbi të cilat ndërtohet zgjidhja e konflikteve si një faktor thelbësor dhe i qëndrueshëm për arritjen e paqes në shoqëritë njerëzore:

1. Fjalët e të Lartmadhërishmit: ***“E Ne të dërguam ty (Muhamed) vetëm si mëshirë për të gjitha krijesat”***.¹¹

2. Fjalët e të Lartmadhërishmit: ***“O ju njerëz, vërtet Ne ju krijuam juve prej një mashkulli dhe një femre, ju bëmë popuj e fise që të njiheni ndërmjet vete, e s’ka dyshim se tek Allahu më i ndershmi ndër ju është ai që më tepër është ruajtur (këqijat) e Allahu është shumë i dijshtëm dhe hollësisht i njohur për çdo gjë”***.¹²

Më poshtë paraqiten disa udhëzime të nxjerra nga objektivat (maqāsīd) e Sheriatit për zgjidhjen e konflikteve:

Sjellja e mirë me njerëzit

Një nga qëllimet themelore të Islamit, si fe hyjnore e dërguar me mesazhin e saj për të gjithë njerëzit, është përhapja e paqes, forcimi i

¹¹ Kur’ani, 21: 107.

¹² Kur’ani, 49: 13.

mirëkuptimit dhe nxitja e bashkëpunimit ndërmjet të gjithë qenieve njerëzore. Ndër dëshmitë që e vërtetojnë këtë janë:

1. Fjalët e të Allahut të Lartmadhërishëm: **“(përkujtoni) Kur ne morëm zotimin e bijve të israilit; mos adhuronit tjetërkë, përveç Allahun, të silleni mire ndaj prindërve, ndaj të afërmeve, ndaj jetimëve, ndaj të varfërve dhe njerëzve u thoni fjalë të mira; faleni namazin dhe jepni zeqatin, e pastaj ju e thyes zotimin dhe përveç një pakice prej jush, ia kthyet shpinën zotimit”**.¹³

Udhëzimi i përmendur në ajet është tepër i qartë në kontekstin e thirrjes për paqe, bashkëpunim dhe mirëkuptim ndërmjet të gjithë njerëzve, sepse komunikimi me njerëzit me fjalë të mira përbën një gur themeli të fortë për ndërtimin e një shoqërie të qëndrueshme dhe të sigurt.

2. Fjalët e të Lartmadhërishmit: **“O ju që besuat! Mos i shkelni simbolet e Allahut, as muajin e shenjtë (mos lejoni luftën), as kurbanin (mos e pengoni), as kurbanin (mos e pengoni), as atë me qafore (të caktuar për kurban), as (mos pengoni) ata që duke kërkuar begati nga Zoti i tyre dhe kënaqësinë e Tij, kanë mësyre (për vizitë) shtëpinë e shenjtë (Qaben). E kur të hiqni ihramin, atëherë gjahtoni. Urrejtja ndaj një populli, që iu pat penguar nga xhamia e shenjtë, të mos ju shtyjë të silleni në mënyrë të padrejtë kundër tyre. Ndihmohuni mes vete me të mira dhe në të mbara, e mosni në mëkatet e në armiqësi. Kini dro dënimit të Allahut, se me të vërtetë Allahu është ndëshkues i fortë”**.¹⁴

Ajeti fisnik përqendrohet në dy pika themelore për arritjen e sjelljes së mirë ndaj njerëzve:

1. Ndalimin e dhunës dhe të padrejtës ndaj njerëzve për shkak të armiqësisë ose urrejtjes.

2. Urdhërimin për bashkëpunim në vepra të mira dhe devotshmëri, dhe mosbashkëpunim në mëkatet dhe armiqësi.

3. Fjalët e Allahut të Lartmadhërishëm: **“Allahu nuk ju ndalon të bëni mire dhe të mbani drejtësi me ata që nuk ju luftuan për shkak të fesë, e as nuk ju dëbuan prej shtëpive tuaja; Allahu i do ata që mbajnë drejtësinë”**.¹⁵

Ajeti nxit në sjellje të mirë ndaj njerëzve, në bamirësi dhe drejtësi në marrëdhëniet me ta, sidomos në kohë paqeje dhe larg çdo forme padrejtësie. Ka shumë ajete kuranore dhe hadithe profetike që theksojnë

¹³ Kur’ani, 2: 83.

¹⁴ Kur’ani, 5: 2.

¹⁵ Kur’ani, 60: 8.

këtë qëllim madhor të Islamit, i cili nuk mund të realizohet pa vendosjen e paqes, gjykimin me drejtësi midis njerëzve, eliminimin e padrejtësive dhe diskriminimit në shoqëri, si dhe zgjidhjen e konflikteve dhe parandalimin e tyre.

Qëllimi i hilafetit (Maqsad el-Khilāfa)

Kur'ani e ka përshkruar njeriun si mëkëmbës (zëvendës) i Zotit në Tokë, ashtu siç thuhet në fjalën e Allahut të Lartësuar: *“(Përkujto Muhamed) Kur Zoti yt u tha engjëjve: ‘Unë po krijoj (po përcaktoj) në tokë një zëvendës’! Ata thanë: ‘A do të veshë në të atë që bënë çrregullime dhe që derdh gjaket, e ne të madhërojmë Ty me lavdërimin Tënd dhe plotësisht të adhurojmë’! Ai tha: ‘Unë di atë që ju nuk e dini’!”*.¹⁶

Duke u nisur nga roli i njeriut si zëvendësues (halifë) në Tokë, ai duhet të jetë një element pozitiv në të, si në marrëdhëniet me njerëzit, ashtu edhe me krijesat që e rrethojnë. Halifja është ai që punon për ndërtimin dhe zhvillimin e tokës, e jo për shkatërrimin e saj; ai synon të vendosë drejtësinë dhe të gjykojë me të drejtë ndërmjet njerëzve, qofshin ata myslimanë apo jo, dhe kujdeset për mirësinë ndaj të gjithëve si dhe për përmirësimin e shoqërisë.

Allahu i Lartësuar ka thënë për rolin e halifes duke folur për të dërguarin e Tij, Davudin (a.s.): *“O Davud: ‘Ne të kemi bërë sundimtar në tokë, e ti pra gjyko me drejtësi mes njerëzve, e mos shko pas dëshirave se ato të shmangin prej rrugës së Allahut. Ata që largohen prej rrugës së Allahut i pret dënim i rëndë për shkak se e harruan ditën e përgjegjësisë’”*.¹⁷

Pa dyshim, angazhimi për zgjidhjen e konflikteve dhe parandalimin e tyre ndërmjet njerëzve - qofshin ata individë, shtete apo grupe - përbën një nga qëllimet thelbësore të rolit të halifes, të cilin Allahu i Madhëruar e ka vendosur në Tokë.

Parandalimi i çrregullimit në tokë

Parandalimi i çrregullimit përbën një nga qëllimet themelore të Sheriatit Islam për të siguruar lumturinë e njeriut, ndërtimin e një shoqërie të sigurt dhe përmirësimin e gjendjes së njerëzve. Çrregullimi

¹⁶ Kur'ani, 2: 30.

¹⁷ Kur'ani, 38: 26.

i ndaluar në Sheriatin Islam përfshin të gjitha format e tij - qoftë ekonomik, politik, moral apo i çfarëdo natyre tjetër. Kur'ani fisnik e ka theksuar qartë këtë qëllim në shumë ajete, duke treguar se Allahu nuk e do çrregullimin dhe urdhëron që ai të parandalohet në tokë.

Allahu i Madhërishëm ka thënë: ***“Ka ndonjë nga njerëzit që fjala e tij të mahnit, por vetëm në këtë botë (pse në botën tjetër gjykon Ai që i di të fshehtat), dhe për atë që ka në zemrën e tij, e paraqet Allahun dëshmuës, e në realitet ai është kundërshtari më i rreptë. E posa të kthehet, ai në tokë vepron të bëjë shkatërrim në te, të asgjësojë të korrat (mbjelljet) dhe gjallesat. E Allahu nuk e do çrregullimin (fesadin)”***.¹⁸

Allahu i Madhërishëm ka thënë: ***“Mos bëni çrregullime në tokë pas rregullimit të saj dhe luteni atë duke pasur frikë (dënimin) dhe duke shpresuar (mëshirën). S’ka dyshim se mëshira e Allahut është pranë atyre të mirëve”***.¹⁹

Allahu i Madhërishëm ka thënë: ***“O populli im, veproni drejtë gjatë matjes dhe peshimit, e mos dëmtoni njerëzit në asgjë dhe mos shkaktoni rrëmuje në tokë”***.²⁰

Këto ajete tregojnë se çrregullimi në tokë është i refuzuar dhe i dënueshëm, sepse ai bie ndesh me qëllimin themelor të sheriatit, që është ndërtimi i një shoqërie njerëzore të drejtë dhe të qëndrueshme, ku njerëzit jetojnë me siguri dhe dinjitet. Konfliktet pengojnë arritjen e këtij qëllimi; prandaj, angazhimi për zgjidhjen e mosmarrëveshjeve dhe parandalimin e tyre është thelbësor për të siguruar një jetë të qëndrueshme dhe të sigurt. Kjo për shkak se pasojat e konflikteve shpesh janë çrregullimi, përhapja e korrupsionit dhe dëme të tjera të rënda në shoqëri.

Vendosja e drejtësisë ndërmjet njerëzve

Nuk ka dyshim se ai që vëren me kujdes Kur'anin fisnik, gjen në të shumë vende ku flitet për drejtësinë në kontekste të ndryshme, gjë që tregon rëndësinë e madhe që i jepet drejtësisë në Islam. Drejtësia konsiderohet një nga qëllimet thelbësore të Sheriatit Islam. Kur'ani e thekson qartë se gjykimi ndërmjet njerëzve me drejtësi dhe vendosja e drejtësisë në shoqërinë njerëzore janë ndër synimet kryesore të ligjeve hyjnore që janë zbritur gjatë historisë.

¹⁸ Kur'ani, 2: 204-205.

¹⁹ Kur'ani, 7: 56.

²⁰ Kur'ani, 11: 85.

Allahu i Madhërishëm ka thënë: ***“Ne i dërguam të dërguarit Tonë me dokumente të qarta dhe Ne zbritëm me ata librin dhe drejtësinë që t’i përmbahen njerëzit të së drejtës. Ne e kemi zbritur edhe hekurin që në të ka force të forte dhe dobi për njerëz, e edhe për t’u ditur tek Allahu se kush ndihmon Atë (rrugën e Tij) dhe të dërguarit e Tij duke i besuar të fshehtës. S’ka dyshim se Allahu është i fuqishëm, mbizotërues”***.²¹

Në komentimin e këtij ajeti, Sejjid Kutbi thotë: “Të gjitha shpalljet hyjnore kanë ardhur për të vendosur një peshore të qëndrueshme në tokë dhe në jetën e njerëzve, një peshore me të cilën vlerësohen veprat, ngjarjet, gjërat dhe njerëzit. Kjo peshore i mundëson njerëzimit të jetojë në siguri, larg rrëmujës së epsheve, ndryshueshmërisë së dëshirave dhe përplasjes së interesave dhe përfitimeve. Ajo është një peshore e paanshme, sepse shpreh të vërtetën hyjnore që vlen për të gjithë dhe nuk i bën padrejtësi askujt, sepse Allahu është Zoti i të gjithëve. Kjo peshore që Zoti e ka zbritur me të dërguarit e Tij është garancia e vetme për njerëzimin kundër stuhive dhe trazirave që mund të lindin nga epshet, ndjenjat, rivalitetet dhe dashuria për veten.”²²

Allahu ka urdhëruar për drejtësi dhe për virtyte të tjera fisnike, ndërsa ka ndaluar shthurjen, të keqen dhe padrejtësinë, ashtu siç thotë i Madhërishmi: ***“Allahu urdhëron drejtësi, bamirësi, ndihmë të afërmve, e ndalon nga imoraliteti, nga e neveritura dhe dhuna. Ju këshillon ashtu që të merrni mësim”***.²³

Duke u bazuar në këtë, nuk ka dyshim se konfliktet në shoqëritë njerëzore pengojnë realizimin e këtij qëllimi madhor të shariatit, sepse nuk mund të vendoset drejtësia në prani të konflikteve. Nga ky këndvështrim, zgjidhja e konflikteve kontribuon në përmbushjen e qëllimit të shariatit për vendosjen e drejtësisë në shoqëritë njerëzore, gjë që forcon paqen, stabilitetin dhe mirëqenien për të gjithë.

²¹ Kur’ani, 57: 25.

²² Kutb, Sejjid, (2003), *Fi dhilali-l-Kur’an*, botimi i tridhjetë e dytë, Kajro: Dar esh-Shuruk, vëll. XXVII, f. 3494.

²³ Kur’ani, 16: 90.

Conclusions

• **Islamic Sharia** is not merely a religious legal code but a comprehensive regulatory system that aims at achieving happiness, justice, and the well-being of humanity in both this world and the hereafter. It addresses not only the relationship between humans and God but also interpersonal and social relations, laying the foundations for a just and stable order.

• **Respecting and implementing the five general objectives (maqāṣid) of Islamic Sharia** lead to the avoidance of conflicts, the building of mutual trust, and the establishment of lasting peace.

• **Islamic Sharia views the avoidance of conflicts and reconciliation among people** as a divine duty and as a means of realizing its higher objectives. The principles of justice, mercy, cooperation, and reconciliation are clear guidelines for ensuring social peace and harmony.

• **The human being, as God's vicegerent (khalīfah) on earth,** bears the responsibility to build rather than destroy. This role requires active engagement in conflict resolution and the prevention of chaos and disorder in society.

• **Establishing justice among people** is one of the greatest objectives of Sharia. Conflicts and injustices undermine this foundation; therefore, lasting peace can only be achieved through the rule of justice and the respect for human rights.

• **Conflicts are often a source of social disorder and corruption,** thus their prevention and resolution form an integral part of Sharia's objective to preserve order and prevent corruption (fasād) on earth.

• **The objectives of Sharia are not limited to Muslims alone,** but have a universal character. They encompass all of humanity and aim at ensuring a just, peaceful, and harmonious life for all human societies.

Recensentë:

Dr. Mixhit Osmani

Dr. Besim Nuzi

Literatura

Anis, I., & të tjerë. (pa datë botimi). *El-Mu'xhemu el-vesit*. Botimi i dytë. Kajro: Matabi' Dar el-Ma'arif.

Dehlevijj, esh-Shah Uelijjullah. (pa datë botimi). *Huxhxhetullah el-baligha*. Bejrut: Dar el-Ma'rife.

El-'Alemi, J. H. (pa datë botimi). *El-Mekasid el-'amme li-sh-sheri'ati el-islamijje*. Kajro–Hartum: Dar el-Hadith & Ed-Dar es-Sudaniijje.

Fasijj, A. (1983). *Mekasid esh-sheri'a el-islamijje ue mekarimuha*. Kasablankë: Matba'at en-Nexhah el-Xhedid.

Ibn 'Ashur, M. et-T. (1366 h.). *Mekasid esh-sheri'a el-islamijje*. Tunis: Mektebet el-Istikame.

Ibn Faris, Ebu-l-H. A. (1392 h.). *Mu'xhemu mekajisi-l-lugha*. Botimi i dytë. Përgatiti Abdusselam Harun. Egjipt: Sheriket u Mektebet u Matba'at Mustafa el-Babi el-Halebi.

Ibn Manzur, Xh. M. ibn Mukerrem. (pa datë botimi). *Lisan el-'Arab*. Bejrut: Dar Sader.

Jubi, M. S. ibn A. ibn M. (1998/1418 h.). *Mekasid esh-sheri'a el-islamijje ue 'alakatuha bi-l-edille esh-she'r'iijje*. Botimi i parë. Rijad: Dar el-Hixhre.

Kutb, S. (2003). *Fi dhilali-l-Kur'an*. Botimi i tridhjetë e dytë. Kajro: Dar esh-Shuruk.

Shatibijj, Ebu Ishak I. ibn M. M. el-Lahmijj. (pa vit botimi). *El-Muvafekat fi usuli-sh-sheri'a*. Përgatiti M. Muhji-ed-Din Abdu-l-Hamid. Kajro: Mektebet Ali Muhamed Sabih ue euladuh.

Siddikijj, M. N. (2016). *Mekasid esh-sheri'a ue el-hajatu el-mu'asira*. Përkthyer në gjuhën arabe nga M. Rahmetullah en-Nedvijj. Botimi i parë. Damask: Dar el-Kalem.